



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

07.01.2021

Nr. 4703/12 prot.

Gramsh, më ___/12/2020

VENDIM

Nr. 96, datë 28/12/2020

PËR

“DISA NDRYSHIME NE VENDIMIN NR. 96 DATE 30.12.2019 “PER MIRATIMIN E NIVELIT TE TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE ,ADMINISTRIMIN E TYRE SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54 gërma" P", Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit 9632 datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar , VKM Nr. 132 , datë 07.03.2018" Për Metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së Paluajtshme" "ndërtesa" e bazës së taksës për kategori specifike", Ligjit nr.44/2015 "Kodi Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe kontrollin e territorit", V.K.M.1064 datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", Ligjit nr.24 datë 09.03.2017 "Për administrimin e ujitjes dhe kullimit" ,Udhëzimit e Ministrit të Financave nr 24 datë 02.09.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit të përbashkët nr.655/1 datë 06.02.2007" të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Brendshme "Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore", Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 28/12 /2020, pasi mori ne shqyrtim projektin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë "Për disa ndryshime në Vendimin Nr.96, date 30.12.2019 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore , administrimin e tyre si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative”:

VENDOSI

A. Të miratojë ndryshimet në Vendimin Nr.96, date 30.12.2019 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore , administrimin e tyre si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative” si më poshtë :

1. Tek pika 1.(a) “ Llojet e taksave subjekt i këtij vendimi” të hiqet pika “1” “Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel”.
2. Tek Kapitulli “A” Taksat Vendore”, të hiqet pika 1 “Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel”.
3. Tek pika “A.2” “Taksa mbi pasurinë e paluajtshme” , ndryshohet pika “a” Taksa mbi ndërtesën “ vetëm sa i përket tabelave lidhur me cmimet mesatare për ndërtesat për veprimtari ekonomike dhe për banesat e destinuara për banim, e cila bëhet si më poshtë:

Cmimet mesatare per ndertesat per veprimtari ekonomike

Nr	Lloji i Ndertesës	Cmimi referuese I shitblerjes se	Shkalla e taksës sipas ligjit	Cmimi sipas aktivitetit	Shkalla e taksës sipas VKB	Cmimi pefundimtar per m2
----	-------------------	----------------------------------	-------------------------------	-------------------------	----------------------------	--------------------------

		ndertesave				
1	Ndertesa per veprimtari tregtimi e sherbimi	43000	0.2%	1.5 fishi i cmimit te banesave	0.2%	129
2	Parkim te mbuluar dhe bodrume	43000	0.2%	70% e cmimit te siperfaqeve te apartamenteve te banimit	0.2%	60.2
3	Parkim i hapur	43000	0.2%	30% e cmimit te siperfaqeve te apartamenteve te banimit	0.2%	25.8
4	Ndertesa te destinuar per: prodhim, perpunim ose maganizim te mallrave industrial(fabrika, depo, magazine etj)	43000	0.2%	50% e cmimit te siperfaqeve te apartamenteve	0.2%	43
5	Ndertesa qe perdoren per bujqesi dhe blegtori	43000	0.2%	30% e cmimit te siperfaqeve te apartamenteve	0.2%	25.8
6	Biznese Njese Administrative	27950	0.2%	1.5 fishi i cmimit te banesave	0.2%	83.85

Cmimet mesatare per banesat e destinuar per banim

Nr	Lloji i Ndertesave	Cmimi referuese I shitblerjes se ndertesave	Shkalla e takses sipas ligjit	Cmimi I ndryshuar sipas VKM	Shkalla e takses sipas VKB	Cmimi pefundimtar per m2
----	--------------------	---	-------------------------------	-----------------------------	----------------------------	--------------------------

Banesat e privatizuara me Ligjin 7652 date 23.12.1992 70%e Per privatizimin e banesave cmimit 1 shteterore para vitit 1993	43000	0.05%	70% e cmimit referues	0.035%	10.535
Banesat e privatizuara me Ligjin 7652 date 23.12.1992 Per privatizimin e banesave 2 shteterore pas vitit 1993	43000	0.05%		0.035%	15.05
Banesat e privatizuara me Ligjin 7652 date 23.12.1992 70%e Per privatizimin e banesave cmimit 1 shteterore para vitit 1993 Njesi Administrative.	27950	0.05%	70% e cmimit referues	0.035%	6.85
Banesat e privatizuara me Ligjin 7652 date 23.12.1992 Per privatizimin e banesave 2 shteterore pas vitit 1993, Njesi Administrative	27950	0.05%		0.035%	9.78

Përkufizimet, përcaktimet, përjashtimet, afati, struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse mbeten të pandryshuara.

4. Tek kapitulli "B" "Tarifat Vendore", tek "Tarifat për leshimin e dokumentave nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit", Pika "4" Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja " pas pikës 13 shtohet pika 14 "Tarifë për ndryshimin e destinacionit të objektit (nga shërbim në banesë dhe anasjelltas)" si më poshtë:

-Tarifë për ndryshimin e destinacionit të objektit (nga shërbim në banesë dhe anasjelltas)”

- Për ndryshimin e funksionit në objekt banimi 100 lekë/m²
 - Për ndryshimin e funksionit në objekte shërbimi(bar,dyqan, etj.) 200 lekë/m²
- Në cdo rast, tarifa është jo me pak se 10 000 lekë

5. Tek kapitulli “Tarifa në Sektorin e Ujitjes e Kullimit , bëhen ndryshimet :

Kategori, nenkategori e tarifes.	Njësia matëse	Niveli i tarifes
- Tarifa vjetore e mirembajtjes infrastruktures ujitjes e kullimit	Leke/dynym/vit	100
- Tarifa e shërbimit të Ujitjes	Leke/ore/ujitje	100

6. Tek Kapitulli “Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksave dhe tarifave vendore “, bëhen ndryshimet tek pika “1” Afati i pgesës për taksa e tarifa vendore”, si më poshtë:

- Për subjektet e biznesit të vogël brenda datës 30 maj të vitit fiskal dhe për subjektet e reja në momentin kur lind detyrimi.
- Afati për shpërndarjen e vlerësimeve tatimore për subjektet deri më datë 30 mars të vitit fiskal.

7. Taksat e tarifat e tjera,përkufizimet, përcaktimet, përjashtimet,afatet,strukturat e ngarkuara për vjeljen e tyre,etj. mbeten të pandryshuara,sic janë miratuar me VKB nr.96,date 30.12.2019 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore , administrimin e tyre si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative”

8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoritë ,Sektorët pranë Bashkisë dhe Njësitë Administrative.

9. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Xhulia GJINI

Konc.Xh.Gjini
Miratoi.G.Lena
Dosja nr. _____
Afati _____

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Greta LENA

